

**VENDIM**  
**Nr. 36, datë 16.1.2013**

**PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË ZYRËS SË  
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me VKM nr.1048, datë 4.12.2013; nr.215, datë 11.3.2015; nr.902, datë 21.12.2016; nr.524, datë 27.9.2017; nr.689, datë 22.11.2017)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe të pikës 5 të kreut II të vendimit nr. 752, datë 2.11.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës dhe kriterëve për caktimin e anëtarëve të bordit drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe masës së shpërblimit të tyre”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Bordi drejtues i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të kryesohet nga *znj. Majlinda Dhuka, përfaqësues i Kryeministrit, dhe në përbërje të tij të ketë këta anëtarë:*

- a) Z. Artur Metani, përfaqësues i Kryeministrit;*
- b) Znj. Jonida Gaba, përfaqësuese e ministrit të Drejtësisë;*
- c) Z. Artan Lame, përfaqësues i ministrit të Drejtësisë;*
- e) Znj. Gerladina Prodani, përfaqësues i Ministrit të Financave.*

2. Mandati i anëtarëve të bordit drejtues është 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme vetëm një herë.

3. Bordi drejtues ushtron të gjitha përgjegjësitë sipas ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, vendimit nr. 752, datë 2.11.2012 të Këshillit të Ministrave dhe legjislationit në fuqi.

4. Bordi drejtues fillon veprimtarinë e tij jo më vonë se 15 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Pika 4 e kreut V të vendimit nr. 752, datë 2.11.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës dhe kriterëve për caktimin e anëtarëve të bordit Drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe masës së shpërblimit të tyre”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe bordi drejtues për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

---

<sup>1</sup> VKM nr.36, datë 16.1.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.8, 8 shkurt 2013.

VKM 1048, datë 4.12.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.198, 19 dhjetor 2013.

VKM nr.215, datë 11.3.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.39, 18 mars 2015.

VKM nr.902, datë 21.12.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.254, 30 dhjetor 2016.

VKM nr.524, datë 27.9.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.173, 2 tetor 2017.

VKM nr.689, datë 22.11.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.210, 5 dhjetor 2017.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**